

Renco FALASKI

RASTI TELINI

Kah fundi i vitit 1912 profilizohet në Evropë rreziku i një lufte të dimensioneve të gjera, e cila rrodhi krejt pas Kongresit të Berlinit të vitit 1878. Shkathtësitë e Bizmarkut dhe satisfaksionet e Disraelit dukej se e kishin mbyllur një periudhë të stuhishme në Evropë. Francës i ishte dhënë Tunizia për kompensimin modest të humbjes së Alzasit e Lorenës dhe të ndikimit mbi Egjiptin, e për zhgënjimin e Italisë që shihte kështu shfytëzimin pronësor të asaj Tunizie që kishte prosperuar nga mijëra fshatarë sicilianë, Gjermania kishte ofruar pjesëmarrjen me Austro-Hungarinë në Aleancën Tripalëshe jo të natyrshme dhe akoma të fuqishme.

Pika e vetme e përputhjes së marrëveshjes në mes të Fuqive të Mëdha mbetej konsensusi për të mos shkatërruar Perandorinë Osmane, e cila ishte duke vdekur, por për copëtimin e së cilës mungonte edhe një marrëveshje. Për t'ia dhënë goditjen vdekjeprurëse asaj Perandorie ishte Giolitti, i cili, i paaftë për tu përballur me vështirësitë e mbrendshme, përdori strategjinë e vjetër të aktivizimit të nacionalizmit për dhënien e lejes për pushtimin e Libisë, të ndërruar (atëherë) me Tunizinë.

Shembull i kotë, derdhja kriminale e gjakut (për disa decenie) pa kurrëfarë përparimi as për Italinë as për Evropën, sepse Turqia e angazhuar ushtarakisht me Italinë u bë shpejt objekt i presë nga ana e principatave të pakënaqura ballkanike të cilat më në fund shihnin mundësinë e lirimit përgjithmonë nga pushtimi otoman. Lufta e Parë Ballkanike shpërtheu një ditë pas lidhjes së Traktatit të Paqes të cilin Stambolli, duke parë rrezikun e madh ballkanik, e kishte firmosur në shpejtësi me Italinë më 18 tetor 1912. Kështu, Turqia iu shmang serisë së shkatërrimeve dhe i befasoi Fuqitë e Mëdha, të sigurta se Porta e Lartë nuk do të kishte vështirësi të përballëj me një ushtri të fuqishme të udhëhequr e të ushtruar nga gjermanët.

Pas një pune të gjatë e intensive diplomatike të kryer me shkathtësi e përkushtim nga ana e patriotit shqiptar Ismail Qemal Vlora, që arriti ta

sigurojë pëlqimin italian dhe austriak, më 28 nëntor 1912 Shqipëria u shpall e pavarur, duke ia lënë Evropës problemin e një grindjeje të Ballkanit. Për ta ekzaminuar situatën, Qeveria Britanike thërret Fuqitë e Mëdha, të cilat mbliidhen në Londër, për t'i këmbyer ambasadorët e tyre. Tribuna, e njohur si "Konferencë e Ambasadorëve", filloi punimet më 12 dhjetor duke shfaqur menjëherë kontraste të thella që shprehnin shtetet pjesëmarrëse. Rusia e përkrahur nga aleati Franca, me tërë peshën e saj përkrahu Serbinë. Kësaj përkrahjeje iu bashkua edhe Britania e Madhe, e vendosur mirë për të mbajtur në avantazh si shkëmbim për miken e saj Greqinë, ndërsa Italia e Austro-Hungaria, të rrethuara nga Gjermania, duke respektuar Aleancën Tripalëshe, përkrahnin arsyet e shqiptarëve, qëllimi i të cilëve ishte krijimi i një shteti i cili do të përfshinte në kufijtë e saj edhe territoret e atëhershme të banuara me shqiptarë, praktikisht, Kosovën dhe Çamërinë.

Ismail Qemal Vlora, Kryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, në pranverë të vitit 1913, pasi ishte konsultuar me Romën kishte shkuar në Londër dhe atje ishte takuar me shumë miq me ndikim, prandaj kishte shpresë se Konferenca do t'ia njohë të drejtat të gjithë shqiptarëve për të jetuar në një shtet të përbashkët. Kështu ai e shpreh zhgënjimin e thellë ndaj dështimit të përpjekjeve të tij: "Simpatia e shprehur gjatë misionit tim ishte i vetmi ngushëllim i ofruar për zemrën e copëtuar të Shqipërisë... kur i morëm vendimet e Konferencës së Londrës. Më shumë se gjysma e territoreve të vendit tim iu dhanë Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Qytetet më të lulëzuara dhe rajonet më produktive të vendit u morën. Shqipëria gati u reduktua ekskluzivisht në zona malore dhe shkëmbore".

Sër Eduard Grej, që kishte udhëhequr Konferencën, duke iu referuar konkluzioneve në Dhomën e Komunave, thekson se vendimet e marra i nënshtroheshin kritikave nga ata që kishin qenë në rrjedhë të situatës ballkanike, por objektivi i vetëm i Konferencës ishte të evitohet një luftë evropiane dhe kjo e arsyetonte qëllimin.

Kështu që padrejtësisë së copëtimit të Shqipërisë shumë shpejt iu bashkua shpërthimi i një lufte të tmerrshme botërore, që eskaloi më pak se një vit më vonë!

Me dhënien e shënimeve kryesore sipas të cilave Kosova i jepej Serbisë e Çamëria Greqisë, Konferenca e mbajtur në Firencë më 19 dhjetor 1913, formon dy komisione të ngarkuara për definimin e kufijve veriorë dhe të mesëm të Shqipërisë. Komisioni i parë e kryen detyrën pa vështirësi të shumta. Përkundrazi, ai për kufijtë greko - shqiptar përballet me probleme të komplikuara, në pjesën më të madhe të shkaktuara nga pretekset e Athinës për t'i konsideruar greke edhe territoret pjesërisht të banuara nga ortodoksët

shqiptarë, të cilët për nga kultura bashkëjetonin në harmoni të përkryer me shumicën myslimane. Në anën tjetër Konferenca kishte caktuar që qyteti i Korçës, Gjirokastra, Leskoviku, Delvina e Saranda t'i lireshin Shqipërisë, ndërsa Konica e Janina Greqisë.

Kështu ngjarjet e reja kishin ndërruar vullnetin e politikës evropiane dhe vendimet e marra para Luftës së Parë Botërore dhe nga shumë aspekte ishin ballafaquar me probleme të tjera. Austria dhe Gjermania ishin jashtë lojës sa i përkiste Ballkanit, por Italia kishte fituar një prestigj të shquar, kështu që presidenca delikate e "Komisionit Ndërkombëtar për Ndarjen e Kufijve të Shqipërisë" iu rezervua një italiani. Qeveria e Romës diti të zgjedhë njeriun e përshtatshëm si për nga karakteri, ashtu edhe për nga përvoja: gjeneralmajorin Enriko Telini.

I lindur në Kastelnovo Garfanjana më 26 gusht 1871, ai pasi kishte ndjekur Kolegjin Ushtarak të Firences dhe Akademinë Ushtarake të Torinos, më 1890 emërohet nëntoger i artilerisë.

Duke e përsosur shkollën e luftës, më 1903 u avancua në kapiten dhe u transferua në Trupat e Shtetit të Madh. Më 1912 merr pjesë në fushatën e Libisë dhe me meritë e merr një lëvdatë solemne dhe Kryqin e Kalorësve të Rendit Ushtarak të Savojës. Më 1914, duke u avansuar sërish, bëhet i ngarkuari me punë i Atasheut Ushtarak në Vjenë, punë të cilën e ushtron gjersa Italia hyn në luftë. Gjatë kësaj kohe shërben pranë Komandës Supreme duke komanduar artilerinë, e në fund komandon një brigadë në kamp, duke pranuar një promovim për merita të luftës dhe një medalje të argjendtë.

Më 7 qershor 1920 u ftua në Vlorë për të komanduar Brigadën Piacenza. U kthye në atdhe në gushtin e ardhshëm në kohën e një lufte të shkurtër, por të përgjakshme të Vlorës me kryengritësit shqiptarë kur edhe u nënshkrua paqja me Qeverinë e Tiranës që sanksionoi largimin e forcave italiane nga vendi. Telini sërish u ftua në Shqipëri në nëntor të vitit 1921 në cilësi të kryetarit të Komisionit Ndërkombëtar dhe të shefit të delegacionit italian.

Gjashtë delegacione ishin emëruar për definimin e kufijve shqiptarë: delegacion italian, britanik, francez, shqiptar, grek dhe serb. Delegacioni ishte i përbërë nga delegatë që e udhëhiqnin italianët dhe nga ata britanikë dhe francezë.

U soll një zgjidhje për provincën e diskutuar të Korçës me largimin e trupave okupuese greke. Telini iu besoi delegatëve francezë e britanikë të ngarkuar me punë të skicojnë kufirin serbo - shqiptar të zonës së Prizrenit e

të Manastirit, përkatësisht Shën Naumit (Liqeni i Prespës). Kjo detyrë nuk ofronte vështirësi të veçanta, meqë Konferenca e Ambasadorëve kishte përcaktuar një kufi mjaft të precizuar.

Sa i përkiste definimit të kufirit të mbetur greko-shqiptar të Malit Gramsh (rreth 20 km në jug të Korçës) deri te Deti Jon, Telini vendos të marrë personalisht përgjegjësinë e rëndë për ta drejtuar në bazë të karakterit të Protokollit të Firences, ndonëse i të vetëdijshëm se grekët jo vetëm që nuk do të pranojnë, por ata ishin skajshmërisht të vendosur ta sabotonin në favor të tyre. Për motive të bindjes logjistike, Telini vendos shtabin gjeneral të komisionit nga Leskoviku në Janinë, praktikisht në qendër të kufirit kontraverz. Mori me vete përkthyesin shqiptar Athanas Kraveri, i lindur në Leskovik, i cili që përveç gjuhës së tij shqipe, fliste italishten dhe greqishten.

Vështirësitë që Telini i hasi në Korçë me delegatin grek, kolonelin Karkandzos, i cili kishte penguar me çdo mjet lidhjen e një marrëveshje jo konform dëshirave të Athinës ishin të mëdha. Vendimet formalisht të miratuara nga Konferenca e Ambasadorëve u bënë të padurueshme me delegatin e ri Tog dhe me Kolonelin Tak Botzaris, me të cilin edhe raportet personale nuk vonuan e u bënë konfliktuoze. Përveç delegacionit grek, në Janinë u vendos edhe delegacioni shqiptar i udhëhequr nga Perfekt Dhimitër Berati, person me kualitete të shquara profesionale dhe personale, e ku mernte pjesë edhe sekretari i Komisionit, kapiteni francez Limperani.

Qeveritë greke, qofshin monarkike apo republikane, që ndërroheshin, ishin konstante në objektivat e tyre: ato me tërë forcën angazhoheshin ta shtynin kufirin sa më në veri për të grabitur territorin shqiptar, duke përfshirë Korçën, Gjirokastrën dhe Himarën. Ëndërr e vërtetë e Athinës (Megali Idea) në marrëveshje me Beogradin ishte që ajo ta vendosë kufirin serbo - grek në lumin Shkumbin, burimi më i madh i ujit në regjion, i cili që praktikisht e ndanë Shqipërinë në dysh, në lindje dhe në perëndim.

Kundër objektivit "imediat" grek për të fituar jugun e skajshëm të Shqipërisë kundërshtonte nie mjaft ngulm politika italiane, që shprehte gjithmonë nevojën e ruajtjes së kufijve të diktuar nga Protokollit i Firencës. Kësisoj, përfaqëmi italian në Konferencën e Ambasadorëve shprehet me afirmimin e disa motiveve që justifikojnë refuzimin e preteksit grek. Posaçërisht më 1 mars të vitit 1919 kishte bërë të njohur në komisionin ndërkombëtar se regjioni në fjalë ishte i banuar nga një popullatë të shumicës së etnitetit e të gjuhës shqiptare; që statistikisht provonin se numri kundërthënës në mes të myslimanëve dhe ortodoksve mbetej në favor të të parëve edhe pse shumë nga refugjatët myslimanë të ikur nga terrori grek

hezitonin të ktheheshin dhe që, në anën tjetër, pjesa më e madhe e shumicës ortodokse ushqente ndjenja kombëtare shqiptare, natyrisht jo të dobësuar nga krimet e bëra gjatë okupimit grek e të terrorit në mes të viteve 1912 dhe 1917 kundër popullatës shqiptare të çdo besimi; që atakimi i idesë kombëtare dhe vetë gjuhës ishte shprehur vazhdimisht me përsëritjet e kryengritjeve të shqiptarëve kundër pushtimit otoman; që ndryshueshmëria e religjioneve ishte irelevant edhe që në të gjitha religjionet shqiptare myslimanët ishin gjithnjë në mënyrë paqësore të përzier me katolikë e ortodoksë; që pjesa më e madhe e pronësive të themeluara në Çamëri ishte në duart e shqiptarëve; që mungesa e shkollave shqiptare nuk duhej të përdorej kundër Shqipërisë, duke ditur se dominimi otoman nuk kishte lejuar institucionalizimin e shkollave shqipe e që lënda e mësimin krijonte një privilegj të akorduar nga Porta e Lartë e Patriarkatit të Konstantinopojës e nga kjo e ushtruar me kujdes të veçantë pikërisht në territoret e kontestuara; që në vitin 1880 Qeveria greke kishte caktuar kufijtë etnikë si hakmarrje për t'iu përgjigjur kufijve të përcaktuar nga Protokollit i Firencës; e në fund që Shërbimi Gjeografik i Ushtrisë Franceze në vitin 1915 kishte botuar një studim të thelluar, duke theksuar se minoriteti grek vendës në Shqipëri kufizohej në dy vendbanime të vogla pranë Gjirokastrës dhe Delvinës.

Nga sa shënuam mund të marret me mend çfarë situata të vështira duhej të përballonte Telini me detyrën e tij të re të veçantë me një homolog të përcaktuar kësisoj. Për ironi, meriton të përmendet se koloneli i papajtuashëm grek rridhte nga një degë e familjes fisnike shqiptare Boçari (e helenizuar në Botsaris) e që një i afërm i tij, Mark Boçari, ishte shquar si luftëtar me nam në luftën për pavarësinë greke.

Telini, njeri i palëkundur dhe i rryer në dhuntinë e tij, nuk vonohet për të llogaritur se një pjesë e madhe e territoreve të shënuara nga Greqia "në tryezën" e Protokollit të Firences në bazë të një mbivlerësimi të pastër të fuqisë banoheshin nga shqiptarët, që insistonin të ribashkoheshin me atdheun e tyre. Përveç pritjes së marrjes së indikacioneve të paskrupullta, ai përkrahte nevojën të vendoste kufirin sa ishte e mundur konform vullnetit të popullsisë së përzier. Ishte i bindur se vetë qyteti i Janinës, që deri më 1912 ishte kryeqyteti i "vilajetit" të Shqipërisë së mesme, meritonte të mbetej shqiptar, por kjo tejkalonte kufizimet e vëna nga vendimet e Firencës dhe as që duhej të diskutohej. Sipas Telinit, një kufi i pranueshëm duhej të krijohet sa i përket hapësirës më perëndimore kah lumi Kalamash.

Kjo pikëpamje bie ndesh me kundërshtimin e Botsarisit, i vendosur për të mos lëshuar pe ndaj Shqipërisë sipas bindjeve personale dhe nga

urdrat e Athinës. Si pasojë, raportet mes Telinit e Botsarisit shpreheshin mjaft të tendosura, edhe pse mungonte në radhë të parë ndërmjet të të dyve ai minimumi i dispozicionit të kërkuar normal nga një aktivitet i bashkëpunimit me respektimin e parimeve civilizuese. Pastaj, Botsaris dispononte me një gjandarmëri të njohur për nga egërsia, që evidenconte dhe zhvendoste në mënyrë oportune popullatën greke duke kërcënuar atë shqiptare tashmë të terrorizuar. Në fakt, ishte fushatë e shkurtër gjatë së cilës (në qershor të vitit 1917) ushtria italiane kishte pushtuar jugun e Shqipërisë (repartet e regjimentit të kalorësisë "Luka", pasi kaluan Janinën, arritën gjer në Pargë), por që ishte detyruar të tërhiqej nën presionin e aleatëve të tjerë dhe kështu u kishte lejuar grekëve ta ndëshkonin rëndë popullatën që e kishte mbledhur në mënyrë të favorshme Italia, duke i lënë si pre në panikë shqiptarët bestyt.

Më 26 gusht 1923 Telini i shkruan Konferencës së Ambasadorëve: **"Nuk di si ta përshkruaj mënyrën e ashpër të grekëve... kjo më bënë të dyshoj se tërë punën që e kemi bërë do të shkatërrohet nga koloneli grek (Botsaris) i cili shpik gjithnjë pretekste dhe prapavija të reja vetëm sa për t'iu shmangur vendimeve të komisionit për kufijtë... dhe e përmbush detyrën e tij duke u bazuar në vetëdijen dhe të drejtën e tij... nuk di të them se në ç'masë ndiqen vendimet tona nga rezistenca e bërë nga forcat e armatosura të Greqisë.**

P.sh: Pas vendimit të 22 gushtit... vija e kufirit ishte vënë me duart tona në anën e lumit Poro (zona e Sarandës). Por në këtë pikë koloneli grek me një shikim të diktatorit më tha: "Më vjen keq që jeni duke punuar kot, sepse kjo vijë do të hiqet nga armata greke e cila nuk dëshiron të heq dorë nga të drejtat e saj". Ju përgjigja: "Kjo vijë e ka fuqinë e vet e pesha dhe rëndësia e saj do të mbrohet nga forcat aleate... kjo është shenjë e një vendimi të një komisioni të plotfuqishëm". Koloneli shtoi: "Kjo vijë do të kushtojë shumë shtrenjtë...". Ishte ndoshta paralajmërimi për masakrën që po përgatitej?

Atë mbrëmje Telini vendosi që të takoheshin të tri delegacionet në mëngjesin e orës 9 në Kakavi, te kufiri. Delegacionet u nisën nga Janina ndërmjet orës 6 e 7. I pari u nis ai shqiptar, i përcjellur nga ai grek, e në fund, "në një distancë pluhuri" ai italianë i përbërë nga gjeneral Telini, nga mjeku major Luigji Korti, nga togeri gjeografik Mario Bonaçini, nga përcjellësi Farneti dhe nga përkthyesi Kraveri. Pas rreth 17 kilometrave, Telini arrin makinën greke, ndalet për t'i pyetur nëse kanë nevojë për ndihmë. Botsarisi përgjigjet se bëhej fjalë për një prishje të lehtë që do të riparohej nga përcjellësi i tij dhe e fton Telinin ta ndjek pas. Rruga, pas

kalimit të grykës së Dolianës e lokalitetit Kani Delvinaki fillon të zbrësë kah Arinista dhe lumi Fitoki, duke hyrë në një pyll të dendur me lisa rreth 10 kilometra larg Kakavisë. Para se të hyjë në pyll, makina italiane u shtërngua të ndalet dhunshëm para një trungu druri të vënë në mes të rrugës. Në atë moment nga të dy anët e rrugës fillojnë të shtënat e armëve. Mjeku major Korti mbetet i vdekur në vend, të tjerët zbresin nga vetura duke u përprjekur të shpëtonin. Kufoma e Telinit u gjet 50 metra larg nga automobili. Të gjithë i kishin kokat e shpuara nga të shtënat me armë zjarri. Koloneli Botsaris ju bashkohet pakëz më vonë dhe në raportin e tij thekson se dy barinj që gjendeshin në lëndina kishin thënë se s'kishin dëgjuar dhe s'kishin parë asgjë. Kapiteni Limperani, që mbikëqyri transportin e viktimave në Janinë, prej kah kishte arritur pasdite me përfaqësuesit e drejtësisë dhe mjekët ligjor, thekson se kufomat nuk ishin plaçkitur dhe që sipas bindjes së tij ky ishte një delikt politik.

Pezmi i Italisë ishte i madh dhe spontan. Reagimi i Musolinit, kryeministër i zgjedhur 10 muaj më parë, ishte i menjëhershëm e i fuqishëm kur mësoi për masakrën. Qysh në mëngjesin e 28 gushtit, Mussolini hartoi me dorën e tij një shënim duke theksuar se qeveria greke, meqë nuk ishte e njohur, nuk kishte titull për të ofruar sigurimin e dëmshpërblimit të nevojshëm, si represalje dhe garanci për të përmbushur kërkesën e pagimit të 50 milionëve, Italia atëherë duhej ta pushtojë Korfuzin. Qeveria e Greqisë shprehu "keqardhjen e saj të thellë për vrasjen e urryer", shpreh fjalë miradije për punën e shkathtë të gjeneralit Telini, por përkujton se vazhdimisht ia ka tërhequr vëmendjen Qeverisë së Tiranës "për praninë e bandave e brigadave shqiptare afër kufirit" përkundër aktivitetit faktik represiv të patrullave të policisë greke dhe e quan të padrejtë qëndrimin e Qeverisë Italiane sipas të cilit "Qeveria greke mbanë përgjegjësinë pse i ka shkaktuar ofendim të madh Italisë". Përprjekja e Athinës për t'ia mveshur fajin e vrasjes brigadave shqiptare nuk pinte ujë, sepse delegacioni italian ishte ai që pikërisht që luftonte në favor të Shqipësisë dhe nga të tri delegacionet vetëm ai u vra, përkundër faktit se asgjë nuk u vodh nga viktimat.

Për ta bërë të mundshme këtë hipotezë dhe për ta hequr çdo përgjegjësi nga vetja, Qeveria greke përmes policisë sekrete fajësoi një shqiptar refugjat në Stamboll, i cili kishte qenë i dënuar me vdekje në atdhe pasi kishte marrë hakun me vrasjen e një bashkëfshatari të tij në Vlorë. Ky i arratisur, i quajtur Nevruz Bella, vë kontakte të fshehta me drejtorin e spitalit italian të Stambollit, prof. Zandoninin, dhe e informon se autoritetet greke i kishin propozuar të deklarohej fajtor për masakrën bashkë me disa

shqiptarë të tjerë të ikur përtej kufirit. Nëse do të pranonte, i ishte siguruar një dënim i shkurtër e pastaj liria dhe vendqëndrimi si i burgosur politik, përndryshe do t'ia dorëzonin autoriteteve shqiptare për ta përbushur dënimin e mëhershëm.

Bella u ndihmua të mos ndëshkohet, ndërsa informatat e tij menjeherë u përcollën në Romë.

Mirëpo, vendimi për pushtimin e Korfuzit u bë më 31 gusht në orën 16. Fatkeqësisht, një keqkuptim mes Perfektit të ujdhesës dhe komandantit ushtarak pengoi goditjen e tri gjuajtjeve si përshëndetje nga flota italiane dhe si sinjal për të valvitur flamurin e bardhë, e të cilat u përcollën me disa granata që u hodhën fuqishëm, me supozimin se nuk ishin civilë. Ndërsa në ndërtesë kishin qenë të strehuar të ikur të panumërt grekë të ardhur nga Turqia dhe "pak persona" (si i ka deklaruar Musolini përfaqësuesve diplomatikë në Romë) që mbetën "të vdekur nga goditjet e shpejta të kalibrit të vogël të gjuajtura nga anijet italiane). E vërteta ishte se operacioni u krye nga kundëradmirali Angjelo Frank në mënyrë pak të arsyeshme: një vonesë për më shumë se pesë orë e gjysmë për rrugëtimin Galipoli - Korfuz; zvogëlimi nga dy orë në vetëm gjysmë orë për paralajmërimin për dorëzim; angazhimi i artillerisë (një numër i predhave të mesme e jo të kalibrit të vogël) pa pasur pikë nevojë. Tërë kjo prodhoi një atmosferë negative për Italinë kur Greqia në mënyrë energjike, e përkrahur nga Franca dhe Britania e Madhe, bëri apel në Lidhjen e Kombeve kundër okupimit të Korfuzit.

Mirëpo Qeveria Italiane nuk hoqi dorë dhe Athina u shtrengua të pranojë kushtet e diktuarat në Romë: pagimin e 50 milionë lirave, nderimet ushtarake të viktimave dhe një meshë solemne në Athinë, por jo edhe arrestimin e kërkuar të fajtorëve, që nuk u zbuluan kurrë. S'ka kurrëfarë dyshimi se vrasjet u organizuan nga koloneli Botsaris me angazhimin e ushtarakëve të veshur si fshatarë.

Tërheqja e flotës italiane nga Korfuzi nuk kaloi pa anën komike: pasi që ishte dhënë urdhri për largim më 26 shtator, Ministri i Marinës, Duka Taon de Revel, telegrafon në orën 13,30 për të suspenduar evakuimin si pasojë e kundërshtimit anglez për pagimin e 50 milionë lirave nga ana e Greqisë. Me urdhrin tjetër të orës 16,30 të të njëjtës ditë jipej urdhri i konfirmuar për nisje nëse shuma ishte nisur për në Itali. Evakuimi u shty për datën 27, në orën 8,30, por në orën 13,30 një telegram i ri urdhëronte kthimin e menjëhershëm në Korfuz, sepse në realitet shuma ende nuk kishte ardhur në Bankën e Italisë. Braktisja definitive e skuadrës detare italiane nga ujërat e Korfuzit u bë në pasditën e 29 shtatorit, pasi kishte arritur pagesa e përmendur.

Viktimave, që ishin ngarkuar në Prevezë në anijen Shën Marko 19, me të gjitha nderimet e bëra ushtarake të trupave greke, arritin në Taranto të pasnersërmën dhe menjëherë u transferuan në Romë, ku u zhvillua funerali solemn në praninë e familjarëve, Mbretit, Qeverisë dhe autoriteteve të tjera shtetërore. Kështu punimet e Komisionit Ndërkombëtar u kryen pa incidente të mëdha më 15 shtator, të udhëhequra nga Gjenerali Gazzera, i cili e kishte zëvendësuar Telinin. Greqia megjithatë arriti të marrë një territor prej rreth 750 kilometra katrorë në veri të lumit Kalamash.

Renco FALASKI, ambasador i Italisë

Përktheu nga italishtja: Ilire ZAJMI

Renco Falaski
